



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered	07 - 10	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKAMSHICK	5986	/2022	113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.779/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.779/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Komunën e Podujevës, në çështjen juridike "*masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si pa bazuar** ankesa me numër A.nr.779/2022 e datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

**II. Mbetet në fuqi** masa disiplinore *Vërejtje me shkrim* e shqiptuar ndaj ankuesit përmes shkresës me numër protokoli 116-778 të datës 31.08.2022 të Zëvendësueses e Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 08.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5214/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore *Vërejtje me shkrim* të shqiptuar ndaj ankuesit nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përmes shkresës me numër protokoli 116-778 të datës 31.08.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (tutje MAPL), ndërsa kjo e fundit më datë 13.09.2022 ka përcjell vetëm shkresat lidhur me çështjen ankimore.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 5214/2022 e datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 31.08.2022 të ankuesit dërguar E-mailin e datës 01.09.2022 nga Emailin e datës 01.09.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 05.09.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 02.09.2022 nga për inicim të procedurës disiplinore; Masën disiplinore Vërejtje me shkrim me numër protokoll 116-778 të datës 31.08.2022 të shqiptuar nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 13.09.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 19.02.2014 për ankuesin Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme; E-mailin e datës 19.08.2022 nga për fq. 1/3; E-mailin e datës 17.08.2022, 01.08.2022, 29.07.2022 nga për ankuesin dhe të tjerët; Draft-Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; Raporti i prezencës në punë për periudhën 29.08.2022-01.09.2022 për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen pasi ka shqyrtuar çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*


Nga administrimit i provave materiale rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën *Udhëheqës i Departamentit për Financa dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal* sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 19.02.2013. Me tej sipas shkresave të lëndës Kolegji gjen se Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes emailit të datës 29.07.2022 ka kërkuar nga tani palë ankuese,

dhe që bazuar në të gjeturat dhe rekomandimet sipas Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2021, të rrisin përgjegjësinë lidhur me realizimin e detyrave të punës për këtë vit me qëllim që mos të ketë përsëritje të shkeljeve të njëjta, ndërsa më datë 17.08.2022 Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka kërkuar nga ankuesi dhe Udhëheqësit e tjerë që deri me datë 22 gusht 2022 ti dërgojnë arsyetimet lidhur me rekomandimet e evidentuara sipas Raportit të ZKA-së si dhe të merren masa disiplinore ndaj stafit vartës në rast se evidentohet se të njëjtit kanë neglizhuar punën.

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit në cilësi të Mbikëqyrës se drejtpërdrejt të ankuesit, më datë 31.08.2022 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore *Vërejtje me shkrim*, me arsyetimin se ankuesi nuk ka zbatuar kërkesën e Sekretares së Përgjithshme sipas emailit të datës 01.08.2022 dhe 17.08.2022, duke konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të obligimeve të punës duke ju referua nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore të datës 31.08.2022, pretendon që e njëjta është pa bazë ligjore e qëllimshme dhe e diktuar nga ana e ministrit për të më frikësuar, ushtruar presion në punë.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet*



si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit" dhe nenit 46 po të të njëjtit ligj më të cilin përcaktohet se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. Kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazën e vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës rrjedh së Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankuesit përmes emalit të datës 01.08.2022 dhe 17.08.2022 ka kërkuar nga ankuesi që të dërgohen arsyetimet lidhur me rekomandimet sipas Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe të ndërmerren veprimet e caktuara ndaj zyrtareve përgjegjës në rast se konstatohet neglizhencë në kryerjen e detyrave të punës, ndërsa në bazë të provave të lëndës nuk është vërtetuar së ankuesi të ketë përcjell arsyetimet e kërkuar nga Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme, e mbi bazën e këtyre fakteve Këshilli vlerëson së mos zbatimi i kërkesave dhe urdhëresave të punës të përcjella nga udhëheqësi bie ndesh me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit". Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme të MAPL-së ka cilësuar drejt veprimet e ankuesit si shkelje të lehtë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që mbi këto arsye Kolegji vlerëson së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas konstatimeve dhe të gjeturave si me lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.779/2022

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Arkivit të KPMShCK-së.